



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 1542/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Vera Gashi Bala, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Interior Group” Sh.P.K. me numër unik identifikues 811314244, rr. Skenderbeu p.n., Podujevë, të cilën e përfaqëson U.U, Drejtor, kundër debitorit “FSF” L.L.C., me numër unik identifikues 810829004, rr. Pashko Vasa Nr.2-1, Prishtinë, të cilën e përfaqëson V.I, Drejtor Menaxhues, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.998/21 të datës 08.12.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 29.07.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi i pa bazuar prapësimi i debitorit “FSF” L.L.C., me numër unik identifikues 810829004, i paraqitur kundër urdhrin përmbartimor P.nr.998/21 të datës 08.12.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr.998/21 i datës 08.12.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.998/21 të datës 08.12.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve të besueshme-faturave: Fatura nr.14/19 e dt.19.11.2019 dhe Fatura nr. 15/19 e datës 20.11.2019 dhe dëftesës së pagesës nr.00000940, dt.18.11.2021 me të cilin vërtetohet pagesa e përsëritshme e borxhit në vlerë prej 2,000.00 euro, me të cilin ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin përmbartimor, ti paguaj kreditorit borxhin, në shumën prej 3001.00 €, me kamatë ligjore 8 % sipas LMD-së, nga dita e caktimit të

përmbarrimit e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet përmbarrimore në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 06/2014 për Tarifat për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për Përmbarrues Privat, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbarrimor duke e kundërshtuar në tërësi si të pabazuar. Shton se faturat nuk janë të nënshkruara nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të debitorit dhe nuk janë të vulosura nga ana e debitorit duke arsyetuar se tek vendi i nënshkrimit të debitorit shihet vetëm një nënshkrim blanko dhe person i paidentifikuar nga ana e debitorit. Shton se sipas certifikatës nga ARBK shihet qartë se janë katër pronar dhe drejtori i cili është i autorizuar si i vetmi person me të drejtë për të vepruar në emër të kompanisë, duke përfshirë edhe pranimin e faturave si në rastin konkret. Tutje shton se nuk ka asnjë dëshmi se debitori i ka pranuar kopjet fizike të këtyre faturave, i referohet aktvendimit të Gjykatës së Apelit 5040/17 të datës 15.02.2018 me të cilin Gjykata e Apelit kishte gjetur se nuk mund të vërtetohet se faturat janë nënshkruar nga vet debitori. Tutje ka shtuar se nuk kanë efekt juridik faturat e lëshuara nga ana e kreditorit dhe çdo pretendim tjetër i kreditorit duhet të iniciohet në procedurë kontestimore për faktin që shërbimi i ofruar nga Kreditori nuk ka pasur kualitetin e kërkuar nga Debitori dhe për këtë ka qenë i njoftuar kreditori mirëpo nuk ka përmirësuar shërbimin konform kualitetit të kërkuar. Nga gjykata ka kërkuar të aprovohet në tërësi prapësim, të anulohet Urdhri Përmbarrimor P.nr.998/21, të anulohen të gjitha veprimet e kryera në procedurë si dhe të detyrohet kreditori t'ia kompensoj shpenzimet procedurale Debitorit.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim dhe duke shtuar se vërehet qartazi se qëllimi i tij është vetë shtyrja dhe prolongimi i pagesës së borxhit që ka ndaj kreditorit. Lidhur me pretendimet e debitorit që faturat nuk janë pranuar dhe nënshkruar nga personi i autorizuar, kreditori deklaroi se nuk qëndrojnë pasi që debitori me datë 18.11.2021 ka bërë pagesë të pjeshme të borxhit me çka vërtetohet se faturat janë të pranuar nga debitori. Tutje thekson se për pretendime nuk ka sjellë asnjë dëshmi me të cilën do të vërtetoheshin pretendimet siç kërkohet me nenin 69 par.4 i LPP-së. Faturat kanë të gjitha tiparet e përmbarrueshmërisë në kuptim të nenit 21 lidhur me nenin 29 par.1 dhe 1.3 të LPP-së, pra kanë cilësi të dokumentit të besueshëm, përfundoi ai. Nga gjykata ka kërkuar të refuzoj prapësimin si të pabazuar ndërsa urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi. Në rast se debitori parashtron ankesë, kërkon që Gjykata të njëjtin ta obligoj të paguaj

garancion bankar konform, nenit 78 të LPP-së, po ashtu i kërkoi shpenzimet e krijuara në emër të përpilimit të përgjigjes në prapsim, sipas tarifave të parapara.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat: Fatura nr.14/19 e dt.19.11.2019 dhe Fatura nr. 15/19 e datës 20.11.2019 në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Me këtë rast gjykata ka konstatuar se urdhri i dhënë nga përmbaruesi privat është i mbështetur me dokument të besueshëm, përkatësisht faturat e lartcekura, vlera e të cilave është më e lartë, mirëpo nga dëftesa për pagesë me nr.00000940, dt.18.11.2021 vërtetohet se është realizuar pagesa e pjesshme e borxhit në vlerë prej 2,000.00 euro, andaj vlera e kërkuar është 3000.00 Euro. Këto fatura i plotësojnë të gjitha kërkesat e një dokumenti të besueshëm siç përcaktohet në nenin 29 paragrafi 3 të LPP-së. Faturat identifikojnë qartë palët e përfshira, përkatësisht kreditorin dhe debitorin, përshkruan mallrat ose shërbimet e mbuluara nga faturat dhe specifikojnë shumën që i detyrohet debitori.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, mbajnë nënshkrimin e kreditorit dhe debitorit, janë të vulosura nga palët, dhe të njëjtat nuk janë kontestuar nga debitorit.

Prandaj, gjykata nuk mund të pranojë pohimin e debitorit se nuk dihet kush është pranuesi i këtyre faturave, pasi që nga vetë fakti se personat që e kanë vulosur faturën e kanë poseduar vulën, vërtetohet se ata kanë qenë të autorizuar për pranimin e faturës.

Gjykata po ashtu i vlerësoi edhe pretendimet e debitorit lidhur me kualitetin e shërbimeve të ofruara nga kreditori dhe se për këtë ka qenë i njoftuar kreditori dhe të cilat edhe përkundër njoftimit nuk i ka përmirësuar, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbartimi.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendim.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1542/22, datë 29.07.2023

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.